



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE**

Nr. ____ / Prot.

Tiranë, më ____ / ____ / 2018

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM
NË MARRËVESHJEN KUADËR**

[Data] 18.10.2018

Për: “ERZENI/SH”sh.p.k me NIPT J66902027T, Adresa: Lagjja Bahçallek, Rruga Nacionale Shkoder-Tirane.

* * *

Procedura e prokurimit: Procedurë e hapur me mjete elektronike-mallra

Numri i referencës së procedurës : Reference REF-83448-08-21-2018

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Furnizim vendosje pajisje mjekësore dhe mobilimi për qendra shëndetësore” – Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 1 vjeçar (12 muaj)

Publikime të mëparshme (jo): Buletini i Njoftimeve Publike [27.08.2018] [34]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomike më e favorshme

Fondi limi në total (Vlera e pritshme e kontratave që mund të lidhen gjatë marrëveshjes kuadër për të gjitha lotet): 158,529,940 (njëqind e pesëdhjetë e tetë milion e pesëqind e njëzet e nëntë mijë e nëntëqind e dyzet) lekë pa TVSH, i ndarë në lote: —

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë me vlerat përkatëse të ofruara:

- | | |
|---|------------------|
| 1. ROAL sh.p.k
Vlera 129,900lekë pa TVSH | NIPT J61811001M |
| 2. ERZENI/SH sh.p.k,
Vlera 156,100lekë pa TVSH | NIPT J66902027T, |
| 3. ALEN-CO
Vlera 158,500lekë pa TVSH | NIPT K83213401M, |
| 4. ARDENO
Vlera 160,200lekë pa TVSH | NIPT K11804001T |
| 5. MUCA
Vlera 187,680200lekë pa TVSH | NIPT K01421002H |

6. **BOE FARMANET dhe EMKO sh.p.k** NIPT K92201080V,
Vlera **199,290** lekë pa TVSH
7. **ERALD sh.p.k,** NIPT J74517205P
Vlera **210,200** lekë pa TVSH
8. **SHAGA** NIPT J96822229J,
Vlera **216,580** lekë pa TVSH
9. **BUNA** NIPT J61826501C
Vlera **244,100** lekë pa TVSH
10. **BOLT** NIPT K91517011V
Vlera **256,600** lekë pa TVSH
11. **ALMEDICAL sh.p.k** NIPT K21511002I
Vlera **257,245** lekë pa TVSH
12. **MONTAL sh.p.k,** NIPT J62009007F,
Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike
13. **ROYAL BERAT** NIPT K02701025C,
Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

- **Operatori Ekonomik ROAL sh.p.k,** rezulton se:
 - Ka paraqitur të gjithë dokumentacionin e kërkuar në kriteret e përgjithshme.
 - Nuk ka paraqitur të gjithë dokumentacionin e kërkuar në kriteret e vecanta të pranimit kualifikimit (KVK), konkretisht:

Ka keto mangesi:

1- Ne formularin e ofertes shtojca 1, OE RO-AL shpk ka deklaruar se per artikullin 4 dhe 6 kompania prodhuese eshte RO-AL, TOP LINE, dhe si vend prodhimi ka deklaruar Turqi, Kine, nderkohe qe Certifikaten ISO dhe CE e kerkuar per artikujt 4 dhe 6 i ka te prodhuesit PROMEK, nga i cili ka dhe autorizim prodhuesi. Gjithashtu RO-AL ka paraqitur autorizim prodhuesi nga EVFARMA e cila eshte distributor i autorizuar i prodhuesit NINGBO GREETMED MEDICAL INSTRUMENTS CO, dhe ka paraqitur edhe ISO e CE per artikujt 4 dhe 6 edhe te NINGBO GREETMED MEDICAL INSTRUMENTS CO. Nisur nga ky fakt duket qarte qe OE RO-AL artikujt 4 dhe 6 nuk i prodhon vete pra nuk eshte kompania prodhuese ROAL.

Pra duhej qe per artikujt 4 dhe 6 ne formularin e ofertes te deklarohesh si kompani prodhuese PROMEK, Turqi ose NINGBO GREETMED MEDICAL INSTRUMENTS CO, Kine.

Ky gabim përbën shkak për skualifikim për arsye se sipas pikës 1.1 të Seksionit II të DST, oferta refuzohet nëse nuk përgatitet në përputhje me DST.

- **Operatori Ekonomik ALEN-CO sh.p.k,** rezulton se:
 - Ka paraqitur të gjithë dokumentacionin e kërkuar në kriteret e përgjithshme.
 - Nuk ka paraqitur të gjithë dokumentacionin e kërkuar në kriteret e vecanta të pranimit kualifikimit (KVK), konkretisht:

1. Operatori ekonomik **ALEN-CO** nuk ploteson piken 7 te kriterëve teknike ku kerkohet të paraqiten katalogë teknikë për të gjithë artikujt e ofertuar ku të jenë të pasqyruara specifikimet teknike të kërkuara për secilin artikull. **OE ALEN-CO ne kataloget e paraqitur rezulton se nuk permbushen** specifikimet teknike te artikujve te ofruar ne kataloget me ato te percaktuara ne shtojcen e specifikimeve teknike e konkretisht verehen keto mangesi:

- **Per artikullin nr.1 Karrige stafi/ personeli, mjeku pune** : Ne specifikimet teknike ne DST kerkohet , “*Karrige Mjeku me krahë, e lëvizshme, me 5 rrota me bazën plastike të zezë, pjesa mbështetëse imiton shpinën dhe ka fleksibilitetin e duhur për tu mbështetur; komforte, e veshur me copë ose lëkurë me material kundra zjarrit, antibakterial, të padepërtushëm nga uji dhe të lavashëm, me rregjstrues lartësie për të ngritur dhe ulur karrigen. (pesha rreth 12kg, lartësia e shpinës jo më e vogël se 90/107cm, lartësia e ndenjësës jo më të vogël se 45/52cm, thellësia jo më e vogël se 44cm, gjerësia jo më e vogël se 58cm.)*”. Ne katalogun e paraqitur ne specifikimet teknike per kete artikull nuk eshte e specifikuar qe copa duhet te jete e veshur me copë ose lëkurë me material kundra zjarrit, antibakterial, të padepërtushëm nga uji dhe të lavashëm, sikunder eshte kerkuar ne specifikime.

- **Per artikullin 3 Tavoline pune mjeku**, ne specifikimet teknike ne DST kerkohet , “*Tavolinë pune mjeku, me suprinë me material laminant të plastifikuar; me përmasa jo më të vogla se 90/107cm (120x80x75 cm), me kënde të rrumbullakosura dhe të veshura me material të plastifikuar; me 4 (katër) këmbë material inkosi, këmbët mat tub oval, në njërën anë të tavolinës (të majtë ose të djathtë) janë të inkuorporuar 2 sirtarë me përmasa jo më të vogla se 90/107cm (40x40x30cm) secili sirtar; me doreza metalike ngjyrë gri mat. Materiali i tavolinës duhet të jetë i fortë, ti rezistojë kohës dhe lagështirës, dhe të jetë i pastrueshëm*”. Ne katalogun e paraqitur ne specifikimet teknike per kete artikull nuk jane pershkruar specifikimet teknike te kerkuara konkretisht: Përmasa jo më të vogla se 90/107cm (120x80x75 cm), tavolina e paraqitur ka permasat 1400x700x740. Kerkohet te jete me 4 (katër) këmbë material inkosi , këmbët mat tub oval, Ne katalog rezulton se nuk i ka kembet tub oval por ne secilen ane ka kembe te derdhura ne forme drejtkendore. Eshte kerkuar qe te kete të inkuorporuar 2 sirtarë me përmasa jo më të vogla se 90/107cm (40x40x30cm) secili sirtar, ne specifikimet teknike ne katalog nuk i ka te specifikuar permasat e sirtareve, sikunder eshte kerkuar ne specifikime.

- **Per artikullin nr 4 Shtrat Vizitash**, ne specifikimet teknike ne DST kerkohet , *Shtrat vizitash me përmasa jo me te vogla se (180x57x h73cm, pesha max 100kg), me dy pjesë: pjesa shpinore e cila ka mundësi të lëvizë në disa pozicione, e paisur me dyshek të veshur me material rezistent kundra zjarrit, antibakterial dhe të lavashëm, me permasa jo me te vogla se (130x61x h5.5cm) e pjesës së fiksuar, dhe me permasa jo me te vogla se (50x61xh 5.5cm) e pjeses se shpinores, e kornizuar; e pasiuur me 4 këmbë inoksi, e paisur në fund të shtratit me mbajtësen e letrës rulo universal*”. Ne katalogun e paraqitur ne specifikimet teknike per kete artikull nuk jane specifikuar karakteristikat e dyshekut i cili eshte kerkuar te jete i veshur me material rezistent kundra zjarrit, antibakterial dhe të lavashëm, sikunder eshte kerkuar ne specifikime.

- **Per artikullin nr. 7 Dollap mjeku** ne specifikimet teknike ne DST kerkohet , “*Dollap mjeku për dhomë konsulte me permasa jo me e vogël se (80x50xh200) me dy hapsira. Njera per te varur rroba dhe tjetra raft. Me kapak gjatësor të kornizuar me element metalikë me kënde të rrumbullakosura, materiali laminat me trashësi 2.5 cm, këmbët e dollapit të mbulura (jo të dukshme). Brenda kanatit duhet te jene te inkastruar aksesoret per vendosje kremastari etj.*”. Ne katalogun e paraqitur ne specifikimet teknike per kete artikull nuk eshte e specifikuar qe material eshte laminat me trashësi 2.5 cm, sikunder eshte kerkuar ne specifikime.

- **Per artikullin nr. 8 Element gjysem i hapur** ne specifikimet teknike ne DST kerkohet “*Element gjysem i hapur per arkivim dokumentacioni jo me të vogël se (80x50xh200cm) me material laminant trashesi jo me të vogël se 2.5 cm, me bordure te plastifikuar, me kanata ne pjesen e poshteme. I gjithë rafti duhet te jete i ndare vertikalisht ne 5 hapsira . Kembet duhet te jene metalike me lartesi jo me të vogël se 10cm*”. Ne katalogun e paraqitur ne specifikimet teknike per kete artikull nuk plotesohet kriteri I dimensioneve pasi ka paraqitur keto dimensione (80*33*175 cm), nuk ka te pershkruar as trashesine jo me të vogël se 2.5, gjithashtu nga fotoja ilustruese elementi nuk eshte gjysem i hapur por eshte komplet i hapur, gjithashtu nuk ka te permendur as faktin qe kembet duhet te jene metalike me lartesi jo me të vogël se 10cm, sikunder eshte kerkuar ne specifikime.

- **Per artikullin 9 Karrige për pritje holli e thjeshtë** ne specifikimet teknike ne DST kerkohet “*Set Karrige Vizitorësh, të përbëra nga 3 karrige të lidhura bashkë, ku ndenjëset janë të veshura me material kundra zjarrit, antibakterial, të padepërtueshëm nga uji dhe të lavashëm dhe shpinorja është e përbërë nga një material të fortë (laminant).*” Ne katalogun e paraqitur ne specifikimet teknike per kete artikull nuk permendet qe materiale eshte kundra zjarrit, antibakterial, i paderpueshem nga uji, sikunder eshte kerkuar ne specifikime.

-**Per artikullin 10 F.V Perde-Roler me mekanizëm kerkohet**, ne specifikimet teknike ne DST kerkohet “*Perde-Roler me mekanizëm në anë, për uljen dhe ngritjen e saj, për dritare. Copa të jetë me material cilësor jo transparent dhe antibakterial.*”. Ne katalogun e paraqitur ne specifikimet teknike per kete artikull nuk permendet qe materiali i perdes eshte antibakterial sikunder eshte kerkuar ne specifikime.

-**Per artikullin 11 F.V Reception një post** ne specifikimet teknike ne DST kerkohet “*Materiali do te jete laminant me trashësi jo me të vogël se 2.5 cm me bordurë të plastifikuar. Syprina e dyte duhet të jetë laminat me bordure te plastifikuar dhe duhet te kapet me te paren . Në brendësi, recepsioni do të ketë 1 komodine me nga 3 sirtarë, me përmasa jo me të vogla se (45x45xh65 cm) me material laminat me trashësi jo me të vogël se 2.5 cm me bordurë të plastifikuar, me 4 rrota.*”. Ne katalogun e paraqitur ne specifikimet teknike per kete artikull nuk permendet dhe nuk ka specifikime per trashesine e materialit laminat, nuk specifikohet qe recepsioni do të ketë 1 komodine me nga 3 sirtarë, nuk specifikohen as përmasat e komedines qe duhet te jene jo me të vogla se (45x45xh65 cm) me material laminat me trashësi jo me të vogël se 2.5 cm me bordurë të plastifikuar, me 4 rrota, sikunder eshte kerkuar ne specifikime.

- **Per artikullin 12 Reception për tre poste, me dy nivele** ne specifikimet teknike ne DST kerkohet “*Materiali do te jete laminant me trashësi jo me të vogël se 2.5 cm me bordurë të plastifikuar. Syprina e dyte duhet të jetë me material laminat me bordure te plastifikuar. Në brendësi, recepsioni do të ketë 3 komodina me nga 3 sirtarë, me përmasa jo më të vogla se (45x45xh65 cm) me material laminat me trashësi jo me të vogël se 2.5 cm me bordurë të plastifikuar, me 4 rrota.*”. Ne katalogun e paraqitur ne specifikimet teknike per kete artikull nuk permendet dhe nuk ka specifikime per trashesine e materialit laminat si dhe nuk eshte e evidentuar fakti qe do të ketë 3 komodina me nga 3 sirtarë, as përmasat e komedines te cilat duhet te jene jo më të vogla se (45x45xh65 cm) me material laminat me trashësi jo me të vogël se 2.5 cm me bordurë të plastifikuar, me 4 rrota, sikunder eshte kerkuar ne specifikime.

- **Per artikullin 13 Raftet per ilace dhe pajime te vogla mjekesore 40x80x84** ne specifikimet teknike ne DST kerkohet “*Materiali I perdorur eshte MDF I melaminuar, Elementet vertikale dhe horizontale jane 12 mm, Mobilja e sipërme do te fiksohet me prixhionere ne mur me dy kanate me doreza inoksi, Kapaket do te trajtohen me bordime te plastifikuara, Bangoja do te jete e plastifikuar ngjyre gri metalizato, Pjesa e poshtme do të ketë në horizontalitet 2 ndarje me*

nga kater rafte në secilën anë ku secili raft te hapet me doreze inoksi, Ngjyra e kapakeve e bardhe perle”. Ne katalogun e paraqitur ne specifikimet teknike per kete artikull gjithashtu edhe nga foto ilustruese rezulton se jane paraqitur specifikime teknike komplet te ndryshem nga ato te kerkuar nga Autoriteti e konkretisht pasi:ne katalog permasat e raftit jane 1030x500x2000mm, gjithashtu nuk eshte e specifikuar materiali i perdorur, specifikat qe elementet vertikale dhe horizontale jane 12 mm, mobilja e siperme do te fiksohet me prixhionere ne mur me dy kanate me doreza inoksi, kapaket do te trajtohen me bordime te plastifikuara, bangoja do te jete e plastifikuar ngjyre gri metalizato, pjesa e poshtme do të ketë në horizontalitet 2 ndarje me nga kater rafte në secilën anë ku secili raft te hapet me doreze inoksi, sikunder eshte kerkuar ne specifikime.

- **Operatori Ekonomik MUCA sh.p.k,** rezulton se:

- Ka paraqitur të gjithë dokumentacionin e kërkuar në kriteret e përgjithshme.
- Nuk ka paraqitur të gjithë dokumentacionin e kërkuar në kriteret e vecanta të pranimit kualifikimit (KVK), konkretisht:

1. Operatori ekonomik **MUCA** nuk ploteson piken 7 te kriterëve teknike ku kerkohet të paraqiten katalogë teknikë për të gjithë artikujt e ofertuar ku të jenë të pasqyruara specifikimet teknike të kërkuara për secilin artikull. **OE MUCA ne kataloget e paraqitur rezulton se nuk permbushen** specifikimet teknike te artikujve te ofruar ne kataloget me ato te percaktuara ne shtojcën e specifikimeve teknike e konkretisht verehen keto mangesi:

- **Per artikullin nr.1 Karrige stafi/ personeli, mjeku pune** : Ne specifikimet teknike ne DST kerkohet , “*Karrige Mjeku me krahë, e lëvizshme, me 5 rrota me bazën plastike të zezë, pjesa mbështetëse imiton shpinën dhe ka fleksibilitetin e duhur për tu mbështetur, komforte, e veshur me copë ose lëkurë me material kundra zjarrit, antibakterial, të padepërtushëm nga uji dhe të lavashëm, me rregjstrues lartësie për të ngritur dhe ulur karrigen. (pesha rreth 12kg, lartësia e shpinores jo më e vogël se 90/107cm, lartësia e ndenjësës jo më të vogël se 45/52cm, thellësia jo më e vogël se 44cm, gjerësia jo më e vogël se 58cm.)*”. Ne katalogun e paraqitur ne specifikimet teknike per kete artikull nuk eshte e specifikuar qe copa duhet te jete e veshur me material kundra zjarrit, antibakterial, të padepërtushëm nga uji dhe të lavashëm.

-**Per artikullin nr 4 Shtrat Vizitash,** ne specifikimet teknike ne DST kerkohet , “*Shtrat vizitash me përmasa jo me te vogla se (180x57x h73cm, pesha max 100kg), me dy pjesë: pjesa shpinore e cila ka mundësi të lëvizë në disa pozicione, e paisur me dyshek të veshur me material rezistent kundra zjarrit, antibakterial dhe të lavashëm, me përmasa jo me te vogla se (130x61x h5.5cm) e pjesës së fiksuar, dhe me përmasa jo me te vogla se (50x61x h 5.5cm) e pjeses se shpinores, e kornizuar, e pasur me 4 këmbë inoksi, e paisur në fund të shtratit me mbajtësen e letrës rulo universal*”. Ne katalogun e paraqitur nuk pershkruan karakteristikat e dyshekut i cili eshte kerkuar te jete me peshe maksimale 100kg, si dhe eshte kerkuar te jete i veshur me material rezistent kundra zjarrit, antibakterial dhe të lavashëm.

-**Per artikullin nr. 8 Element gjysem i hapur kerkohet,** ne specifikimet teknike ne DST kerkohet “*Element gjysem i hapur per arkivim dokumentacioni jo me të vogël se (80x50xh200cm) me material laminant tarshesi jo me të vogël se 2.5 cm, me bordure te plastifikuar, me kanata ne pjesen e poshteme. I gjithe rafti duhet te jete i ndare vertikalish ne 5 hapsira . Kembet duhet te jene metalike me lartesi jo me të vogël se 10cm*”. Ne katalogun e paraqitur per kete artikull nuk plotesohet kriteri I dimensioneve pasi ka paraqitur keto dimensione (200x80x40 cm), gjithashtu nuk ka te permendur as faktin qe kembet duhet te jene metalike me lartesi jo me të vogël se 10cm, sikunder jane kerkuar ne specifikime.

- **Per artikullin 9 Karrige për pritje holli e thjeshtë** ne specifikimet teknike ne DST kerkohet

“Set Karrige Vizitorësh, të përbëra nga 3 karrige të lidhura bashkë, ku ndenjëset janë të veshura me material kundra zjarrit, antibakterial, të padepërtushëm nga uji dhe të lavashëm dhe shpinorja është e përbërë nga një material të fortë (laminant).” Ne katalogun e paraqitur nga operatori nuk është e pershkruar asnjë prej specifikimeve teknike por ka vetem foton ilustruese te setit 3 karrikeve.

Per artikullin 13 Raftë per ilace dhe pajime te vogla mjekesore 40x80x84 ne specifikimet teknike ne DST kerkohet “Materiali I perdorur eshte MDF I melaminuar, Elementet vertikale dhe horizontale jane 12 mm, Mobilja e siperme do te fiksohet me prixhionere ne mur me dy kanate me doreza inoksi, Kapaket do te trajtohen me bordime te plastifikuara, Bangoja do te jete e plastifikuar ngjyre gri metalizato, Pjesa e poshtme do të ketë në horizontalitet 2 ndarje me nga kater raftë në secilën anë ku secili raft te hapet me doreze inoksi, Ngjyra e kapakeve e bardhe perle”. Ne katalogun e operatorit si foto ilustruese permasat e raftit jane 40x80x100, jane te ndryshme nga ato te kerkuara ne specifikime.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se oferta e dhënë nga operatori ekonomik **Muca Nuk** përmbush të gjithë kriteret e kërkuar në dokumentet e tenderit referuar listës së kërkesave të tenderit të shpallur në sistemin elektronik të APP në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” kreu VII neni 66, pika 3, kjo ofertë skualifikohet.

- **Operatori Ekonomik BOE FARMANET dhe EMKO**, rezulton se:
 - Ka paraqitur të gjithë dokumentacionin e kërkuar në kriteret e përgjithshme.
 - Nuk ka paraqitur të gjithë dokumentacionin e kërkuar në kriteret e vecanta të pranimit kualifikimit (KVK), konkretisht:

1. BOE FARMANET dhe EMKO nuk ploteson kriterin e kerkuar ne piken 1 te Kapaciteti teknik ku kerkohet Furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë prej 40% të fondit limit*, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e hapjes së ofertave të kësaj procedure prokurimi. Shënim*: Për efekt të përlllogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, 40% do të aplikohet mbi vlerën e fondit limit në total të parashikuar sipas sasive të pritshme. BOE , nuk e përmbush vleren e kontrates se ngjashme prej 40% e fondit limit fondi limit, sipas perqindjeve te marra persiper ne marreveshjen e bashkepunimit.

Fondi limit është 53,812,590 , 40% i FL është 21,525,036 leke pa tvsh.

Farma Net ka marre persiper 18% ku sipas kesaj % duhet te te paraqese kontrata te ngjashme jo me te vogel se vlera 18% e 40% , ne vlere leku 3,874,506.48 leke pa tvsh.

EMKO ka marre persiper 82% ku sipas kesaj % duhet te te paraqese kontrata te ngjashme jo me te vogel se 82% e 40% , ne vlere leku = 17,650,529,52 leke pa tvsh.

Per përmbushjen e kontratave te ngjashme EMKO ka paraqitur kontrate te ngjashme si dhe disa fatura, nder te cilat Fatura me nr 58, date 29.05.2015 me bleres M.Lezha eshte jashte afatit 3 vjecar nga data e hapjes se procedures 14.09.2018 – 14.09.2015. Vlera e kontrates dhe e faturave te tjera ne total kap vleren prej 8,177,670 lek pa tvsh, pra nuk e përmbush perqindjen e marre persiper ne kuader te plotesimit te 40%, te kontrates se ngjashme, si BOE.

2. BOE FARMANET dhe EMKO nuk ploteson piken 7 te kriterëve teknike ku kerkohet të paraqiten katalogë teknikë për të gjithë artikujt e ofertuar ku të jenë të pasqyruara specifikimet teknike të kërkuara për secilin artikull. **BOE FARMANET dhe EMKO** ne katalogun e paraqitur per artikullin 4 mungojne keto specifikime teknike : te jete paisur me dyshek të veshur me material rezistent kundra zjarrit, antibakterial dhe të lavashëm, dhe as permasat jo me te vogla se (130x61x h5.5cm) e pjesës së fiksuar, dhe me permasa jo me te vogla se (50x61xh

5.5cm) e pjeses se shpinores

- **Operatori Ekonomik ERALD**, rezulton se:
 - Ka paraqitur të gjithë dokumentacionin e kërkuar në kriteret e përgjithshme.
 - Nuk ka paraqitur të gjithë dokumentacionin e kërkuar në kriteret e vecanta të pranimit kualifikimit (KVK), konkretisht:

1. Nuk ploteson kriterin e kërkuar në pikën 5 të Kapacitetit teknik ku kërkohej që “Ofertuesi duhet të paraqesë Çertifikatë konformiteti CE sipas direktivave përkatëse për artikujt Nr. 4 dhe Nr. 6, të përkthyer dhe të noterizuar”. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për të vërtetuar që këto produkte janë CE.

- **Operatori Ekonomik SHAGA**, rezulton se:
 - Ka paraqitur të gjithë dokumentacionin e kërkuar në kriteret e përgjithshme.
 - Nuk ka paraqitur të gjithë dokumentacionin e kërkuar në kriteret e vecanta të pranimit kualifikimit (KVK), konkretisht:

1. Operatori ekonomik **SHAGA** nuk ploteson pikën 7 të kriterëve teknikë ku kërkohej të paraqiten katalogë teknikë për të gjithë artikujt e ofertuar ku të jenë të pasqyruara specifikimet teknikë të kërkuara për secilin artikull. **OE SHAGA në kataloget e paraqitur rezulton se nuk përmbushen** specifikimet teknikë të artikujve të ofruar në kataloget me ato të përcaktuara në shtojcën e specifikimeve teknikë e konkretisht verëhen këto mangësi:

- **Per artikullin nr.1 Karrige stafi/ personeli, mjeku pune** : Në specifikimet teknikë në DST kërkohej , “*Karrige Mjeku me krahë, e lëvizshme, me 5 rrota me bazën plastike të zezë, pjesa mbështetëse imiton shpinën dhe ka fleksibilitetin e duhur për tu mbështetur, komforte, e veshur me copë ose lëkurë me material kundër zjarrit, antibakterial, të padepërtueshëm nga uji dhe të lavueshëm, me rregjstrues lartësie për të ngritur dhe ulur karrigen. (pesha rreth 12kg, lartësia e shpinës jo më e vogël se 90/107cm, lartësia e ndenjësës jo më të vogël se 45/52cm, thellësia jo më e vogël se 44cm, gjerësia jo më e vogël se 58cm.)*”. Në katalogun e paraqitur në specifikimet teknikë për këto artikull nuk janë të specifikuar asnjë prej këtyre specifikave: (pesha rreth 12kg, lartësia e shpinës jo më e vogël se 90/107cm, lartësia e ndenjësës jo më të vogël se 45/52cm, thellësia jo më e vogël se 44cm, gjerësia jo më e vogël se 58cm.)

- **Per artikullin 2 Karrige për pacientin (dhomë vizite mjeku)**. Në specifikimet teknikë në DST kërkohej , “*Karrige për pacientin, komforte, e kornizuar me 4 këmbë metalike të palëvizshme. (pesha 7kg, lartësia e shpinës jo më e vogël se 82cm, lartësia e ndenjësës jo më e vogël se 45cm, thellësia rreth 43cm, gjerësia rreth 53cm.)*”. Në katalogun e paraqitur mungojnë këto specifikime (pesha 7kg, lartësia e shpinës jo më e vogël se 82cm, lartësia e ndenjësës jo më e vogël se 45cm, thellësia rreth 43cm, gjerësia rreth 53cm.)

- **Per artikullin 3 Tavoline pune mjeku**, në specifikimet teknikë në DST kërkohej , “*Tavolinë pune mjeku, me suprinë me material laminant të plastifikuar, me përmasa jo më të vogla se 90/107cm (120x80x75 cm), me kënde të rrumbullakosura dhe të veshura me material të plastifikuar, me 4 (katër) këmbë material inkosi, këmbët mat tub oval, në njërin anë të tavolinës (të majtë ose të djathtë) janë të inkorporuar 2 siartarë me përmasa jo më të vogla se 90/107cm (40x40x30cm) secili sirtar, me dorëza metalike ngjyrë gri mat. Materiali i tavolinës duhet të jetë i fortë, ti rezistojë kohës dhe lagështirës, dhe të jetë i pastrueshëm*”. Në katalogun e paraqitur nuk janë të përshkruara specifikimet teknikë të kërkuara konkretisht: Përmasa jo më të vogla se

90/107cm (120x80x75 cm), tavolina e paraqitur ka permasat 1400x700x740. Kerkohet te jete me 4 (katër) këmbë material inkosi , këmbët mat tub oval, Ne katalog rezulton se nuk i ka kembet tub oval . Eshte kerkuar qe te kete të inkorporuar 2 sirtarë me përmasa jo më të vogla se 90/107cm (40x40x30cm) secili sirtar, nuk i ka te specifikuara permasat e sirtareve.

- **Per artikullin nr 4 Shtrat Vizitash**, ne specifikimet teknike ne DST kerkohet , *Shtrat vizitash me përmasa jo me te vogla se (180x57x h73cm, pesha max 100kg), me dy pjesë: pjesa shpinore e cila ka mundësi të lëvizë në disa pozicione, e paisur me dyshek të veshur me material rezistent kundra zjarrit, antibakterial dhe të lavashëm, me permasa jo me te vogla se (130x61x h5.5cm) e pjesës së fiksuar, dhe me permasa jo me te vogla se (50x61xh 5.5cm) e pjeses se shpinores, e kornizuar, e pasur me 4 këmbë inoksi, e paisur në fund të shtratit me mbajtësen e letrës rulo universal*”.Ne katalogun e paraqitur nuk pershkruhen keto karakteristika: qe dysheku i ka permasat jo me te vogla se (130x61x h5.5cm) e pjesës së fiksuar, dhe me permasa jo me te vogla se (50x61xh 5.5cm) e pjeses se shpinores, e kornizuar, si dhe nuk ka te specifikuar qe ky shtrat ka apo jo në fund të shtratit me mbajtësen e letrës rulo universal, nuk evidentohet as nga fotoja ilustruese nese shtrati ka mbajtësen e letrës rulo.

-**Per artikullin 11 F.V Reception një post** ne specifikimet teknike ne DST kerkohet *“Materiali do te jete laminant me trashësi jo me të vogël se 2.5 cm me bordurë të plastifikuar. Syprina e dyte duhet të jetë laminat me bordure te plastifikuar dhe duhet te kapet me te paren . Në brendësi, receptioni do të ketë 1 komodine me nga 3 sirtarë, me përmasa jo me të vogla se (45x45xh65 cm) me material laminat me trashësi jo me të vogël se 2.5 cm me bordurë të plastifikuar, me 4 rrota.”*. Ne katalogun e paraqitur nga operatorit rezulton se receptioni do të ketë 1 komodine me nga 4 sirtarë, me përmasa jo me të vogla se (45x45xh65 cm) nderkohe qe ne specifikime eshte kerkuar me 3 sirtare gjithashtu nuk jane dhene permasat e komodines, sikunder jane kerkuar ne specifikimet teknike.

- **Per artikullin 12 Reception për tre poste, me dy nivele** ne specifikimet teknike ne DST kerkohet *“Materiali do te jete laminant me trashësi jo me të vogël se 2.5 cm me bordurë të plastifikuar. Syprina e dyte duhet të jetë me material laminat me bordure te plastifikuar. Në brendësi, receptioni do të ketë 3 komodina me nga 3 sirtarë, me përmasa jo më të vogla se (45x45xh65 cm) me material laminat me trashësi jo me të vogël se 2.5 cm me bordurë të plastifikuar, me 4 rrota.”*. Ne katalogun e paraqitur nga operatori, rezulton se receptioni do të ketë 3 komodina me nga 4 sirtarë, me përmasa jo me të vogla se (45x45xh65 cm) nderkohe qe ne specifikime eshte kerkuar me 3 sirtare gjithashtu nuk jane dhene permasat e komodines, sikunder jane kerkuar ne specifikimet teknike.

● **Operatori Ekonomik BOLT**, rezulton se:

- Ka paraqitur të gjithë dokumentacionin e kërkuar në kriteret e përgjithshme.
- Nuk ka paraqitur të gjithë dokumentacionin e kërkuar në kriteret e vecanta të pranimit kualifikimit (KVK), konkretisht:

1. Operatori ekonomik **BOLT** nuk ploteson piken 7 te kriterëve teknike ku kerkohet të paraqiten katalogë teknikë për të gjithë artikujt e ofertuar ku të jenë të pasqyruara specifikimet teknike të kërkuara për secilin artikull. **OE BOLT ne kataloget e paraqitur rezulton se nuk permbushen** specifikimet teknike te artikujve te ofruar ne kataloget me ato te percaktuara ne shtojcën e specifikimeve teknike e konkretisht verëhen keto mangesi:

- **Per artikullin nr.1 Karrige stafi/ personeli, mjeku pune** : Ne specifikimet teknike ne DST kerkohet , *“Karrige Mjeku me krahë, e lëvizshme, me 5 rrota me bazën plastike të zezë, pjesa mbështetëse imiton shpinën dhe ka fleksibilitetin e duhur për tu mbështetur, komforte, e veshur*

me copë ose lëkurë me material kundra zjarrit, antibakterial, të padepërtushëm nga uji dhe të lavashëm, me rregjstrues lartësie për të ngritur dhe ulur karrigen. (pesha rreth 12kg, lartësia e shpinores jo më e vogël se 90/107cm, lartësia e ndenjësës jo më të vogël se 45/52cm, thellësia jo më e vogël se 44cm, gjerësia jo më e vogël se 58cm.)”. Ne katalogun e paraqitur ne specifikimet teknike per kete artikull nuk eshte e specifikuar qe copa duhet te jete e veshur me copë ose lëkurë me material kundra zjarrit, antibakterial, të padepërtushëm nga uji dhe të lavashëm, si dhe pesha rreth 12 kg.

- **Per artikullin 3 Tavoline pune mjeku,** ne specifikimet teknike ne DST kerkohet , “Tavolinë pune mjeku, me suprinë me material laminant të plastifikuar; me përmasa jo më të vogla se 90/107cm (120x80x75 cm), me kënde të rrumbullakosura dhe të veshura me material të plastifikuar; me 4 (katër) këmbë material inkosi , këmbët mat tub oval, në njërën anë të tavolinës (të majtë ose të djathtë) janë të inkuorporuar 2 sirtarë me përmasa jo më të vogla se 90/107cm (40x40x30cm) secili sirtar; me doreza metalike ngjyrë gri mat. Materiali i tavolinës duhet të jetë i fortë, ti rezistojë kohës dhe lagështirës, dhe të jetë i pastrueshëm”. Ne katalogun e paraqitur ne specifikimet teknike per kete artikull nuk nuk pershkruhen specifikimet teknike te kerkuara konkretisht: Eshte kerkuar qe te kete të inkuorporuar 2 sirtarë me përmasa jo më të vogla se 90/107cm (40x40x30cm) secili sirtar, nuk i ka te specifikuar permasat e sirtareve.

- **Per artikullin nr 4 Shtrat Vizitash,** ne specifikimet teknike ne DST kerkohet , *Shtrat vizitash me përmasa jo me te vogla se (180x57x h73cm, pesha max 100kg), me dy pjesë: pjesa shpinore e cila ka mundësi të lëvizë në disa pozicione, e paisur me dyshek të veshur me material rezistent kundra zjarrit, antibakterial dhe të lavashëm, me përmasa jo me te vogla se (130x61x h5.5cm) e pjesës së fiksuar, dhe me përmasa jo me te vogla se (50x61xh 5.5cm) e pjeses se shpinores, e kornizuar, e pasur me 4 këmbë inoksi, e paisur në fund të shtratit me mbajtësen e letrës rulo universal”*. Ne katalogun e paraqitur ne specifikimet teknike per kete artikull nuk nuk pershkruhen karakteristikat e dyshekut i cili eshte kerkuar te jete i veshur me material rezistent kundra zjarrit, antibakterial dhe të lavashëm.

- **Per artikullin 9 Karrige për pritje hollie e thjeshtë** ne specifikimet teknike ne DST kerkohet “*Set Karrige Vizitorësh, të përbëra nga 3 karrige të lidhura bashkë, ku ndenjësët janë të veshura me material kundra zjarrit, antibakterial, të padepërtushëm nga uji dhe të lavashëm dhe shpinorja është e përbërë nga një material të fortë (laminant).*” Ne katalogun e paraqitur nga operatori nuk eshte e specifikuar qe materiale eshte antibakterial, i paderpertieshem nga uji.

-**Per artikullin 11 F.V Reception një post** ne specifikimet teknike ne DST kerkohet “*Materiali do te jete laminant me trashësi jo me të vogël se 2.5 cm me bordurë të plastifikuar. Syprina e dyte duhet të jetë laminat me bordure te plastifikuar dhe duhet te kapet me te paren . Në brendësi, receptioni do të ketë 1 komodine me nga 3 sirtarë, me përmasa jo me të vogla se (45x45xh65 cm) me material laminat me trashësi jo me të vogël se 2.5 cm me bordurë të plastifikuar; me 4 rrota.”*. Ne katalogun e paraqitur nga operatori nuk permenden dhe nuk ka specifikime per trashesine e materialit laminat dhe nuk specifikohen përmasa e komedines qe jane jo me të vogla se (45x45xh65 cm) me material laminat me trashësi jo me të vogël se 2.5 cm me bordurë të plastifikuar, me 4 rrota.”.

- **Per artikullin 12 Reception për tre poste, me dy nivele** ne specifikimet teknike ne DST kerkohet “*Materiali do te jete laminant me trashësi jo me të vogël se 2.5 cm me bordurë të plastifikuar. Syprina e dyte duhet të jetë me material laminat me bordure te plastifikuar. Në brendësi, receptioni do të ketë 3 komodina me nga 3 sirtarë, me përmasa jo më të vogla se (45x45xh65 cm) me material laminat me trashësi jo me të vogël se 2.5 cm me bordurë të plastifikuar; me 4 rrota.”*. Ne katalogun e paraqitur nga operatori nuk permenden dhe nuk ka specifikime per trashesine e materialit laminat dhe nuk specifikohen përmasa e komedines qe jane jo me të vogla se (45x45xh65 cm) me material laminat me trashësi jo me të vogël se 2.5

cm me bordurë të plastifikuar, me 4 rrota.”.

- **Operatori Ekonomik ALMEDICAL**, rezulton se:
 - Ka paraqitur të gjithë dokumentacionin e kërkuar në kriteret e përgjithshme.
 - Nuk ka paraqitur të gjithë dokumentacionin e kërkuar në kriteret e vecanta të pranimit kualifikimit (KVK), konkretisht:

1. Operatori ALMEDICAL ne formularin e ofertes ka deklaruar qe artikujt 1, 2, 5 i ka te kompanise prodhuese GIMA, Itali pra nuk i prodhon vete, nisur nga kjo ka detyrimin qe te provoje lidhjen ndermjet ALMEDICAL dhe GIMAS.

2. Operatori ekonomik ALMEDICAL nuk ploteson piken 7 te kriterëve teknike ku kerkohet të paraqiten katalogë teknikë për të gjithë artikujt e ofertuar ku të jenë të pasqyruara specifikimet teknike të kërkuara për secilin artikull. **OE ALMEDICAL ne kataloget e paraqitur rezulton se nuk permbushen** specifikimet teknike te artikullit te ofruar ne kataloget me ato te percaktuara ne shtojcen e specifikimeve teknike e konkretisht verehen keto mangesi:

- **Per artikullin nr.1 Karrige stafi/ personeli, mjeku pune** : Ne specifikimet teknike ne DST kerkohet , “*Karrige Mjeku me krahë, e lëvizshme, me 5 rrota me bazën plastike të zezë, pjesa mbështetëse imiton shpinën dhe ka fleksibilitetin e duhur për tu mbështetur; komferte, e veshur me copë ose lëkurë me material kundra zjarrit, antibakterial, të padepërtushëm nga uji dhe të lavashëm, me rregjstrues lartësie për të ngritur dhe ulur karrigen. (pesha rreth 12kg, lartësia e shpinores jo më e vogël se 90/107cm, lartësia e ndenjësës jo më të vogël se 45/52cm, thellësia jo më e vogël se 44cm, gjerësia jo më e vogël se 58cm.)*”: Ne katalogun e paraqitur ne specifikimet teknike per kete artikull nuk eshte e specifikuar duhet te jete e veshur me copë ose lëkurë me material kundra zjarrit, antibakterial, të padepërtushëm nga uji dhe të lavashëm.

- **Per artikullin nr 4 Shtrat Vizitash**, ne specifikimet teknike ne DST kerkohet , *Shtrat vizitash me permase jo me te vogla se (180x57x h73cm, pesha max 100kg), me dy pjesë: pjesa shpinore e cila ka mundësi të lëvizë në disa pozicione, e paisur me dyshek të veshur me material rezistent kundra zjarrit, antibakterial dhe të lavashëm, me permase jo me te vogla se (130x61x h5.5cm) e pjesës së fiksuar, dhe me permase jo me te vogla se (50x61xh 5.5cm) e pjeses se shpinores, e kornizuar; e pasur me 4 këmbë inoksi, e paisur në fund të shtratit me mbajtësen e letrës rulo universal*”. Ne katalogun e paraqitur ne specifikimet teknike per kete artikull nuk i permbahet permaseve te kerkuara pasi ka paraqitur shtrat me keto permase (185x65x70), as pesha max 100kg , nuk jane specifikuar karakteristikat e dyshekut i cili eshte kerkuar te jete i veshur me material rezistent kundra zjarrit, antibakterial dhe të lavashëm, as permaset e dyshekut, sikunder eshte kerkuar ne specifikime.

- **Operatori Ekonomik MONTAL** rezulton se :
 - Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike;
 - Nuk ka paraqitur dokumente për të vërtetuar dhe plotësuar kriteret e kualifikimit
- **Operatori Ekonomik ROYAL BERAT** rezulton se :
 - Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike;
 - Nuk ka paraqitur dokumente për të vërtetuar dhe plotësuar kriteret e kualifikimit

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se është identifikuar si operatorë ekonomikë I suksesshëm:

1. ERZENI/SH sh.p.k

J66902027T

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera **156,100** (njëqindë e pesëdhjet e gjashtë mijë e njëqindë) leke pa tvsh.

(me numra dhe fjalë)

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me adresë Rruga e Kavajës, Tiranë] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5(pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 21.09.2018.

Ankesa:

- Ankesa e operatorit ekonomik RO- AL shpk, me Nr. 4944/4 prot., datë 25.09.2018, të cilës ju kthye përgjigje, nga KSHA e ngritur për shqyrtimin e ankesës me shkresën Kthim Përgjigje Nr. 4944/10 prot., datë 01.10.2018 ku sipas dispozitivit vendosi Pranimin e pjesshëm të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik RO-AL, duke lënë të skualifikuar operatorin RO-AL shpk.
- Ankesa e operatorit ekonomik ARDENO shpk, me Nr. 4944/6 prot., datë 27.09.2018, të cilës ju kthye përgjigje, nga KSHA e ngritur për shqyrtimin e ankesës me shkresën Kthim Përgjigje me Nr. 4944/14 prot., datë 03.10.2018, ku sipas dispozitivit vendosi Mospranimin të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ARDENO, duke lënë në fuqi vendimin e KVO-se.
- Ankesa e operatorit ekonomik MUCA shpk, me Nr.4944/7 Prot., datë 27.09.2018, të cilës ju kthye përgjigje, nga KSHA e ngritur për shqyrtimin e ankesës me shkresën Kthim Përgjigje me Nr. 4944/16 prot., datë 03.10.2018, ku sipas dispozitivit vendosi Pranimin e pjesshëm të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik MUCA, duke lënë të skualifikuar operatorin MUCA shpk.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Arian Kraja

